



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

**Procesverbal i mbajtur më 28 janar 2026, në mbledhjen e I-të (parë) -e rregullt, mandati VIII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Isak Shabani, Artrit Mulliqi, Adelinë Stublla, Qëndresë Hajrizi, Alisa Jetullahu, Enis Shabani, Ekrem Rrahmani, Mimoza Abdullahu, kurse mungoi Haki Rudari), lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin; z.Fahri Restelica Nënkyetar i Komunës, Saranda Stublla Uka U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, Vigan Salihu U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE.

### **Rendi i ditës**

**z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, sot është mbledhja e parë e KPF-së e këtij mandati dhe besoj se thirrjen dhe materialin përkatës të kësaj mbledhje të gjithë e keni marrë me kohë dhe keni mund të shihni se cilat janë pikat e rendit të ditës, andaj para se ta hedh në votim këtë rend të ditës pyes se a dëshiron fjalën ndokush për ndonjë sugjerim, rekomandim apo diçka tjetër, nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë rend të ditës sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, informoj se shefi i Grupit të LVV-së z.Haki Rudari është jashtë shtetit dhe se e ka lajmëruar s nuk do të mund të jetë prezent në këtë mbledhje dhe në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

## 1. Raporti përmbledhës i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025

**z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit**, theksoi, kemi Raportin e punës së Kuvendit për vitin 2025 të cilin besoj e keni marrë me kohë dhe keni mund ta analizoni. E kam vërejtur se është mjaft përmbledhës por mbi të gjitha këtë e ka nënshkruar ish Kryesuesi i Kuvendit për atë kohë sa ka qenë Kryesues i Kuvendit si dhe pjesën tjetër prej që jam unë Kryesues në këtë Mandat e kam nënshkruar unë, andaj e hapi debatin rreth kësaj ike të rendit të ditës, urdhëroni.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, tani unë nuk kam të drejt të të kapem ty sepse nuk ke qenë Kryesues i Kuvendit në vitin 2025, me përjashtim të dy seancave të fundit, por e kam marrë dhe e kam analizuar këtë Raport në bazë të të cilit kemi bërë disa punë të mira mirëpo nuk janë cekë pikat e rendit të ditës të cilat kanë qenë në Planin e punës dhe që nuk janë mbajtur, ka shumë të tilla, shembull në legjislaturën e kaluar pika Të Ndryshme, sidomos në vitin 2025 është mbajtur shumë rrallë sepse zakonisht kemi mbete pa kuorum sepse shkonin në shtëpi e që thënë të drejtën nuk a pasë edhe shumë faj ish Kryesuesi por asambleistët të cilët nuk rrinin në seanca. Po ashti Informatat e drejtorëve të Drejtorive shumica prej tyre nuk janë mbajtur, përjashto këtu 2 drejtori të cilat kanë qenë pak më në rregull siç ka qenë ish drejtoresha e cila është këtu prezentë znj.Adelinë Stublla e Drejtorisë së Shëndetësisë, dhe drejtoresha e Bujqësisë, të tjerët nuk i kanë mbajtur, mirëpo shpresoj që kur te bëjmë Planin e ri për vitin 2026, do t'i përmbahemi dhe do t'i mbajmë pikat e planifikuara por ta shohim tani në këtë mandat se qysh po shkon.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, sa i përket Raportit përmbledhës të punës së Kuvendit për vitin 2025, ne si Grup i LVV-së jemi gjithçka në rregull. Pajtohem pak a shumë me vërejtjet e kolegut, mirëpo ky Raport është gjithçka në rregull.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjeër dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen e caktuar për datën 29.02.2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, natyrisht me ato vërejtje dhe sugjerime që u paraqiten nga parafolësi.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të këtij Raporti, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## 2. Propozim vendimi për formimin e Komisionit Ad-Hoc për hartimin e draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026

**z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit**, theksoi, ne e dim që duhet të përgatitim një Plan të punës së Kuvendit për vitin 2026 dhe pajtohem plotësisht me atë që u potencua paraprakisht se Plani i punës së Kuvendit duhet të zbatohet mundësisht sa më shumë të jetë e mundur, prandaj siç e keni parë në material është përgatitur një propozim vendim për formimin e një Komisioni ad-hoc për hartimin e draft Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026, dhe nëse pajtoheni propozimi është që të jenë 11 anëtarë/e ku është paraparë që Kryesuesi i Kuvendit të jetë edhe Kryesues i Komisionit në fjalë, kurse mendimi im është që anëtarët tjerë nga radhët e Kuvendit të Komunës të jenë nga të gjitha subjektet e përfaqësuara në Kuvend dhe t'ju lusja që ata anëtarë që caktohen të jenë gjithëherë prezent në takime e komisionit.

Pra përbërja do të jetë unë si Kryesues i Kuvendit, nga një anëtar nga të gjitha subjektet e Kuvendit dhe 4 anëtar nga radhët e Ekzekutivit të Komunës të cilët sigurisht që nesër në seancën e Kuvendit do t'i paraqesin emrat e propozuar ngase zakonisht Plani i punës dhe pikat e rendit të ditës për mbledhje propozohen apo sjellën nga Ekzekutiv dhe natyrisht se duhet të jenë pjesë e hartimit të planit të Punës.

Pas formimit të këtij komisioni dhe hyrjes në fuqi të vendimit, pritet organizimi i takimeve apo konsultave fillestare, pastaj organizimi i një punëtorie njëditore, draftimi i Planit fillestar e pastaj edhe një konsultim publik e pastaj si draft final do t'ia paraqesim Kuvendit për miratim final.

Prandaj ky ka qenë propozimi im, por nëse ndokush nga ju ka ndonjë propozim apo sugjerim ndryshe, mund ta shprehni dhe nuk prish punë asgjë sepse ne këtu jemi për atë punë.

**znj. Adelinë Stublla**, theksoi, pajtohem me propozimin e juaj i nderuar Kryesues që të jenë të përfshira të gjitha subjektet e kuvendit të Komunës në këtë Komision pasi që kur kemi një gjithëpërfshirje të tillë është për mirëseardhje, mirëpo unë vetëm rekomandoj që të paktën të përfille Plani i punës ashtu siç e ceku edhe kolegu parafolës z. Ekrem Rrahmani sepse të gjitha ato planifikime natyrisht që pastaj japin rezultate të përgjegjshme dhe është mirë që të rekomandohet tutje.

**z. Ekrem Rrahmani**, theksoi, po i nderuar Kryesues jam dakord dhe pajtohem që komisioni të përbëhet nga të gjitha subjektet, por para se të del në dëgjim publik jam që të mbahet një punëtori mes anëtarëve të komisionit dhe gjithë anëtarëve të Kuvendit në mënyrë që të ketë edhe propozime të reja, shembull unë i përcjellë edhe Kuvendet tjera dhe çka më pëlqen një pikë që unë do ta shtoja edhe tek ne është se në shumicën e Kuvendeve, shembull nëse seanca mbahet sot dhe ka mungesa të anëtarëve, në seancën e ardhshme si pikë e parë e rendit të ditës është Arsytimi i mungesës, ndërsa tek ne siç e ceku edhe më herët ka pas neglizhencë dhe nuk kemi mund t'i mbajmë pikat e fundi të rendit të ditës sepse gjysma e anëtarëve të Kuvendit pas drekës/pauzës nuk vinin, por nëse ne i'a obligojmë vetës që të arsyetojmë mungesa secili në seancën e radhës, kjo ngase të gjithë mund të kemi mungesa eventuale, gjë kjo nga e cila sigurisht që secili anëtar i Kuvendit do të ishte pak më në gatishmëri dhe nuk do të mungonte shumë pa nevojë, dhe do të bëheshin pak më seriozë duke marrë edhe përgjegjësi.

Pra një pikë e tillë në disa Kuvende të Komunave tjera është si pikë e parë e rendit të ditës Arsytimi i Mungesës, andaj unë do ta parashihja gjithëherë si pikë të parë në rend të ditës Arsytimi i mungesave, kjo sepse askush nuk jepte përgjegjësi për mungesat por vetëm vinin në mëngjes, nënshkruheshin dhe dilnin për derën tjetër atje mbrapa, atyre as nuk i'u shkruhej mungesë as asgjë, dhe po sa shihnin që nuk kanë përgjegjësi i'a shpeshton pastaj.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, pasi që pash një gatishmëri të plotë prej të gjithëve rreth këtij propozim vendimi siç u prezantua, mund t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe me theks sjelljen e emrave të cilët i propozoni për të qenë anëtar në këtë Komision, duke pasë parasysh edhe përfaqësimin gjinorë.

Pajtohem rreth asaj që u cekë nga parafolësi rreth mungesave dhe mendoj se mund të parashohim diçka në Plan të punës rreth kësaj çështje edhe pse e kam parë se në Rregulloren e punës është obligim që për çdo mungesë të paralajmërojnë secili anëtar i Kuvendit, ashtu siç tani më ka lajmëruar z. Valdet Restelica i cili nuk mund të jetë prezent nesër në mbledhjen e Kuvendit ngase ka bërë një intervenim kirurgjik e që edhe raportin mjekësorë ma ka dërguar e që mu ka dukur një kulturë shumë e lartë e kolegut në fjalë të cilit po ashtu i dëshirojmë shërim të shpejtë.

Propozoj që të shkojmë në këtë variante siç është propozuar të ngritët komisioni përkatëse e pastaj mund të merremi me çështje tjera dhe t'i përfshijmë apo jo në Planin e punës.

Nëse më jepni kompetencë pastaj mua si Kryesues unë do t'i organizoj edhe konsultimet publike dhe pastaj pasi të përfundojnë ato do të takohemi si komision dhe do t'i shqyrtojmë kërkesat, propozimet, sugjerimet apo idetë e ndryshme që mund të vijnë dhe që ne a t'i inkorporojmë në Plan apo jo, dhe për fund ne sigurisht se do të mundohemi të jemi korrekt pastaj që ato që i përfshijmë në Plan të mundohemi edhe ti realizojmë. Prandaj mund të votojmë që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të ngritjes së këtij Komisioni pasi që të prezantohen emrat e anëtarëve të propozuar nga të gjitha subjektet politike të Kuvendit dhe 4 nga Ekzekutivi i Komunës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, me theksim që emrat e anëtarëve të propozohen në mbledhjen e Kuvendit..*

### 3. Propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete

**z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit**, theksoi, besoj të gjithë jemi të njoftuar që Komiteti për Komunitete do të përbëhet prej 9 anëtarëve, po ashtu jemi në dijeni se shumica e anëtarëve të këtij Komiteti duhet të jetë nga komunitetet jo shumicë. Njoftimi për të aplikuar ose për t'u propozuar anëtarët nga komunitetet jo shumicë ka qenë publik dhe është respektuar ashtu siç ka qenë në aspektin e procedurave dhe unë sot këtu i kam të gjitha të dhënat e atyre që janë propozuar në mënyrë zyrtare, nëse dëshironi mund edhe t'i shihni se kush janë ata që janë propozuar, mirëpo unë edhe i kam ndarë në një letër vetëm emrat e tyre, numrin e nënshkrimeve, lagjen ku jetojnë dhe të tjera, kjo sepse jemi në dijeni se në dokumentacionet e tyre ka edhe të dhëna personale dhe nuk kemi mund ti bëjmë publike materialet e tyre sipas aplikimeve që janë bërë zyrtarisht në Komunë.

Do të thotë komuniteteve jo shumicë i'u takojnë 5 anëtarë, kurse 4 anëtar duhet të jenë nga Kuvendi i Komunës, dhe tani sa i përket formës së përzgjedhjes së tyre, ne kemi 3 komunitete jo shumicë që janë paraqitur për t'u përfaqësuar në këtë Komitet, janë Rom, Egjiptas, Ashkali, kurse në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës thuhet që të ketë përfaqësues të çdo Komuniteti. Për komunitetet jo shumicë Rom, Egjiptas kemi vetëm nga një kandidat të propozuar që dua të them se këtu nuk kemi shumë çka të diskutojmë sepse janë vetëm nga një të propozuar por vetëm të kalojnë përmes votimit në Kuvend, ndërsa te komuniteti jo shumicë Ashkali po mbesin 3 vende por që janë propozuar 10 kandidat, normale që edhe këtu duhet të jetë përfaqësimi gjinorë dhe këtë po e dim të gjithë kështu që na mbetet t'i votojmë veç e veç secilin prej tyre në Kuvend dhe ata që marrin numër më të madh të votave sigurisht se do të jenë pjesë e përbërjes së Komitetit për Komunitete. Do të thotë janë sjellë 10 kandidat/e të komunitetit Ashkali, të gjithë do t'i nënshtrohen procesit të votimit dhe tre të cilët kanë më së shumti vota do të kalojnë në një formë në votim të tërësishëm për të qenë anëtar/e të Komitetit për Komunitete.

Gjithashtu do të mbeten edhe 4 anëtar/e nga radhët e Kuvendit të Komunës, do të thotë janë 5 anëtar nga komunitetet jo shumicë dhe 4 nga Kuvendi i Komunës, prandaj fillimisht më intereson të di a pajtoheni për këtë përbërje prej 9 anëtarëve e pastaj vazhdojmë me diskutimet dhe sqarimet tjera, tjetër formë nuk besoj që ka, e pastaj vijmë te Grupet tona të Kuvendit të Komunës.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, po t'i shinin kriteret dhe t'i dinim shembull prej këtyre 10 të propozuarve nga komuniteti Ashkali cilët mund të jenë tre paksa më të mirë në mënyrë që edhe të dim pak a shumë dhe të mos hyjmë në gjynah e ta votojmë ndonjë prej tyre, unë personalisht nuk është se e njohë asnjërin prej tyre, pastaj nuk e di sakt sepse nuk e kam shfletuar shumë a kërkohet edhe në këtë Komitet kuota gjinore apo jo, si dhe po ashtu nuk e kam të qartë mënyrën e votimit për këta 10 që do t'i nënshtrohen votimit, qysh do të jetë votimi, qysh do të vendosim, a do të vendosim për ata tre për të cilët mendojmë se janë paksa më të mirë apo qysh do të shkoj kjo çështje në Kuvend.

Sa i përket anëtarëve të Kuvendit, e dim që po mbeten 4 anëtarë, por ndoshta do të ishte pak më mirë të shpjegohet se qysh do të ndahen vendet

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, fillimisht është mirë të diskutojmë dhe të dakordohemi për komunitetet jo shumicë e pastaj diskutojmë edhe për ndahen e 4 vendeve nga Kuvendi i Komunës.

Edhe unë pajtohem përnjëmend që do të ishte mirë të mos hyjmë në gjynah në një formë ndokujt por të mundohemi t'i zgjedhim më të mirët e mundshëm për të qenë përfaqësues të komuniteteve jo shumicë në Komitetin për Komunitete, mirëpo mendoj se kur është një shumicë e mirë edhe po që se ndonjëri mund të jetë jo i duhuri prap mbulohet nga shumica. E them këtë sepse edhe unë mund të them që 99% prej tyre që janë propozuar nuk i njohë, mirëpo me sa kamë vërejtur janë 2 nga dy lagjet e mëdha ku jetojnë komunitetet jo shumicë në Podujevë dhe ka edhe nga fshatrat ku jetojnë komunitete jo shumicë, andaj konsideroj se do të dihte mirë që të zgjedhën nga një prej këtyre lagjeve dhe nga fshati ku jetojnë e banojnë sepse natyrisht se do të kishte përfaqësim më të mirë pastaj të të gjithëve.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, pajtohem që të kenë përfaqësim të gjitha lagjet dhe fshatrat ku ka komunitet jo shumicë.

**znj.Adelinë Stublla**, theksoi, edhe ne pajtohem që përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë të jetë nga çdo lagje dhe vendbanim ku jetojnë komunitetet jo shumicë, sepse përfaqësimi sa më gjithëpërfshirës aq më i dobishëm për komunitetet në përgjithësi.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, t'ju them të drejtën edhe unë e kam menduar këtë, mirëpo mu ka duk paksa e padrejtë pa i fut të gjithë në votim veç e veç, edhe pse nuk besoj se do të mund të unifikohej të gjithë se cilët duhet të jenë anëtar të Komitetit, por të mundohemi që këtë parim ta kemi parasysh që të votohen nga të gjitha lagjet dhe vendbanimet ku jetojnë komuniteti jo shumicë, andaj me këtë qëllim për të bërë më të lehtë edhe i kam përshkruar në letër se kush janë, sa nënshkrime kanë dhe nga cilat vendbanime apo lagje janë. Kështu që secilin prej propozimeve do t'i vëm në votim dhe ata që votohen me më së shumti vota do të jenë edhe anëtar/e të Komitetit për Komunitete.

Përndryshe unë këtu i kam të gjitha dosjet e tyre dhe kushdo mund t'i shikoj.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, pasi që për 2 prej tyre nuk paska konkurrencë sepse qenkan vetëm nga një propozim, mendoj që për të tjerët do të ishte mirë të na prezantohen CV-të e tyre ngase besoj që ata kanë dorëzuar diçka me dokumentacion. Po ashtu do të ishte mirë që të bazohemi sa më shumë të jetë e mundur në kriterin e cekur që secila lagje dhe vendbanim ku ka numër më të madh të banorëve të komunitetit jo shumicë ta kenë përfaqësuesin e tyre në Komitetin për Komunitete, e them këtë sepse shembull mund të ndodh që lagja mbi hekurudhë ka propozuar 5 emra dhe është e padrejtë që të zgjedhën 5 emra vetëm prej tyre.

Gjithashtu mendoj se do të ishte mirë që nesër para se të filloj mbledhja e Kuvendit të kenë një takim konsultativ shefat e Grupeve dhe të kenë një dakordim sa i përket emrave dhe çështjeve tjera për themelimin e këtij Komiteti, shembull të ketë përcaktim për një përfaqësues nga lagja tek hekurudha, një nga lagja te rruga "Skënderbeu" dhe rruga "Xhafer Meta" si dhe një përfaqësues nga pjesa e Orllanit ose Batllavës varësisht ku ka më shumë komunitete jo shumicë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, unë këtu kam dokumentacionin e të gjithë atyre që kanë aplikuar dhe mund t'ju jap nga një kopje kush do që dëshiron, mirëpo duhet pas parasysh që janë disa të dhëna personale. Sa i përket asaj që u propozua të ketë edhe një takim nëse mes shefave të Grupeve unë pajtohem nëse dëshironi ju, pra unë jam i gatshëm të takohemi dhe të gjejmë një dakordim të përbashkët në mënyrë që të shohim se kush ka CV më të mira dhe për kë mund të pajtohem.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, unë i lexova emrat dhe pash që ishte edhe Xhafer Ademi i cili ka marrë pjesë gjithë në Komitetin për Komunitete dhe është goxha i përkushtuar në këtë pjesë dhe zakonisht e ka kryesuar Komitetin për Komunitete pra ka qenë Kryesues, pra për këtë po e di kurse për të tjerët nuk është po e njoh ndonjërin, andaj nëse më shkon fjala ne si Grup do ta votonim Xhafer Ademin, të tjerët nuk është se i njohë.

**znj.Adelinë Stublla**, theksoi, i nderuar Kryesues, nga praktika e kaluar zakonisht Komiteti për Komunitete ka pas një gjithëpërfshirje të lagjeve dhe vendbanimeve ku banojnë komunitete jo shumicë dhe të gjitha kanë të përfshira siç janë lagja tek rruga "Xhafer Meta", lagja te rruga "Ali Ajeti" afër hekurudhës, pastaj te fshati Orllan.

Realisht unë si emër përveç Xhafer Ademit i cili ka qenë edhe Kryesues i Komitetit dhe të cilin e duan komuniteti jo shumicë dhe është një persona gjithëpërfshirës për komunitetin të cilin ai e drejton, e them këtë sepse unë kam rastin si ish drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të kem takime, diskutime dhe trajtim të temave me komunitetin jo shumicë dhe thujse se e njoh deri në një masë dhe e di që këtë person e duan dhe çmojnë si komunitet, kështu që mirë është të kaloj.

Po ashtu edhe Sevdije Mustafën e njoh nga ish përbërja e Komitetit për Komunitete dhe mund të them se është goxha e denjë për përfaqësim në Komitetin për Komunitete. Për të tjerët nuk është se kam ndonjë rekomandim.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, sot jemi në KPF dhe vet fakti që nuk votohet sot përfundimisht për ndonjërin prej anëtarëve por vetëm mund të rekomandojmë për seancën e Kuvendit, unë do të propozoja që ta na jepen emrat e atyre që janë propozuar në mënyrë që t'i diskutojmë nëpër Grupet tona dhe fundja nesër të vijmë në një përfundim se cilët mund të jenë përfaqësues të komuniteteve jo shumicë në Komitetin për Komunitete, përndryshe ne sot mund të diskutojmë se cili është më i mirë, mirëpo faktikisht jemi vetëm 9 anëtarë të Kuvendit, kurse në Kuvend janë 35 anëtar/e të Kuvendit, kështu që mendoj se ne Grupet të nxjerrim nëpër Grupet tona përfundimet tona dhe nesër në Kuvend vetëm t'i votojmë.

*(Nga Kryesuesi i Kuvendit, i'u shpërndahet anëtarëve të KPF-së nga një dokument me emrat e mbiemrat e atyre që janë propozuar për anëtar/e në Komitetin për Komunitete, së bashku me lagjet prej nga propozohen, numrin e nënshkrimeve për secilin dhe çështje tjera të nevojshme).*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se do të ishte e padrejtë nëse nuk i vëm në votim të gjithë të propozuarit ngase mbledhja është publike dhe duhet ta dim dhe ta kemi parasysh se duhet të votohet për të gjithë veç e veç, dhe për këdo që mendojmë si shumicë se mund të jenë më të mirë dhe mund të kenë përfaqësim më të mirë në Komitetin për Komunitete, unë vetëm vëreja një lloj unifikimi për një ose më shumë kandidat të cilët u përmendën nga parafolësit, pastaj kemi nga komuniteti Rom dhe ai Egjiptas vetëm nga një të propozuar të cilët automatikisht vetëm mund të votohen, prandaj mund t'i mendojmë edhe 3 prej komunitetit Ashkali dhe të vijmë në Kuvend me propozime konkrete dhe t'i votojmë.

Gjithashtu në përbërjen e plotë të Komitetit duhet pasë parasysh edhe përfaqësimin gjinor, kështu që nuk do të thoja se do të mund të harmonizojmë gjithë atë që mendojmë apo që duam.

**znj.Mimoza Abdullahu**, theksoi, unë do të propozoja që t'iu jepet përparësi edhe të rinjve që të jenë anëtar/e të komuniteteve jo shumicë duke përfaqësuar komunitetet jo shumicë. Pra jo çdo herë të shkojmë me të njëjtit sepse çdo herë po shohë emrat e përsëritur, kështu që t'ju jepet hapësirë edhe të rinjve që të kenë një qasje dhe ta dëshmojnë veten se çka mund të bëjnë për komunitetet e tyre që përfaqësojnë.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, unë këtu po e shoh një emër të cilin e njoh që është Vlorjana Avdiu e cila mund të jetë anëtare e Komitetit duke përfaqësuar pjesën e Orllanit dhe Batllavës si dhe për shkak të kuotës gjinore, pra më duket si emër serioz, por megjithatë sërish jam për atë që emrat të diskutohen edhe nëpër Grupet tona politike sepse ne mund t'i diskutojmë sot këtu dhe të kemi preferenca por nëpër Grupet tona mund të dalin emra tjerë që mund të kenë një përkrahje më të madhe, kështu që mund t'i diskutojmë edhe nëpër grupet tona edhe njëherë dhe të vijmë me përfundime sa i përket emrave që mund të përkrahen për të qenë anëtar/e në Komitetin për Komunitete.

Takimi mes shefave të Grupeve të subjekteve mund të mbahet nesër para seancës së Kuvendit në mënyrë që brenda mundësive të ketë një dakordim sa i përket emrave për anëtar/e në Komitetin për komunitete nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë nëse pajtoheni, nesër mund të takohemi në zyrën time shefat e grupeve dhe përfaqësuesit e subjekteve tjera dhe të diskutojmë 15/20 minuta para fillimit të seancës, dhe të mundohemi të vijmë me emrat të dakorduar në seancë sepse sa po vërejë unë pothuajse 99% qëndrimet janë të përafuara, pra që t'i kemi orientimet tona dhe pastaj vetëm t'i hedhim në votim.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, ne po e dim se 10 propozimet do të hyjnë në votim, por nëse ne fillojmë dhe votojmë shembull për secilin me vota të njëjta ne mund të mbetemi gjatë në seancë, kështu që më mirë do të ishte të ketë një përafim dhe të marrim një lloj qëndrime.

Tani kam diçka jashtë temës por po e shfrytëzoj rastin t'ju them se këtu mbrapa mungon një ulëse e anëtarit të Kuvendit, para kësaj mbledhje nuk e ceka duke menduar se do të rregullohet kjo mirëpo sërish sot po e shohë të njëjtën gjendje, kështu që kërkoj të rregullohet për nesër në seancë të Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, pra si përfundim po mbetet që nesër 15/20 minuta para orës 10:00 të takohemi shefat e Grupeve dhe përfaqësuesit e subjekteve politike në mënyrë që të mundohemi të gjejmë një pajtueshmëri mes vete për propozimet e komuniteteve jo shumicë në Komitetin për Komunitete dhe nëse kemi një unifikim mund t'i votojmë pastaj.

Tani para se ta hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës kemi edhe çështjen e 4 anëtarëve nga Kuvendi i Komunës, andaj e hap debatin rreth kësaj çështje se qysh mendoni ju, cila është ideja dhe përbërja për ndarjen e vendeve nga Kuvendi i Komunës që të jenë anëtar/e në Komitetin për Komunitete.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, lidhur me këtë çështje unë për përbërjen e KPF-së i kam pasë komplet të sqaruara se qysh ndahen vendet kurse për këtë Komitet nuk është se kam hulumtuar se qysh ndahen vendet dhe nuk e di saktë. Këtu realisht jemi tri Grupe të subjekteve politike, kështu që ne tani duhet të vendosim që ose t'ju japin një vend këtyre subjekteve që janë jashtë Grupeve ose Grupit më të madh t'ia bëjmë 2 anëtarë, nuk e di qysh mendohet të bëhet kjo, pra nuk e di saktë qysh do të bëhet kjo përbërje me matematikë, qysh ndahen, përndryshe këtu kemi edhe Zyrën ligjore dhe besoj se këta e kanë hulumtuar këtë dhe mund ta dimë më shumë se qysh mund të ndahen.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, ne sot mund të kemi një orientim sa i përket ndarjes së vendeve apo përqindjes që do të kenë Grupet në këtë Komitet, ndërsa në Kuvend mund edhe të ndryshohet apo të votohet ndryshe. T'ju them të drejtën përqindjen e ndarjes së vendeve goxha vështirë është ta ndajmë.

Te përbërja e KPF-së rregullohet ndarje e vendeve sipas përfaqësimit të entiteteve politike, kurse për këtë Komitet nuk rregullohet qartë specifikisht, do të thotë është më shumë politike. Edhe unë jam që përfaqësuesit e Grupeve të jenë në Komitet dhe nëse pajtoheni kam propozim që të shkohet me 2, 1, 1, përndryshe nuk besoj se ka formulë tjetër rreth kësaj ndarje, nëse pajtoheni mund të shkojmë me këtë propozim në seancën e Kuvendit, por mund të ndryshohet edhe nesër nëse ndokush ka ndonjë qëndrim apo propozim ndryshe, pra 2 anëtarë/e LVV, 1 anëtar/e LDK-ja dhe 1 anëtar/e PDK, pra kemi 4 anëtarë/e të Kuvendit dhe nuk e di se qysh mund t'ju japim vendet atyre tjerëve, kjo formulë mund të mos na bie të gjithëve tamam por për atë jemi këtu që të diskutojmë dhe të ndryshojmë nëse veç pajtohemi dhe të ndryshojmë brenda këtij numri.

**znj.Mimoza Abdullahu**, theksoi, kam pyetje rreth numrit të përbërjes së Komitetit se a duhet të jetë tek.

**z.Ekrem Rrahmani**, përgjigje parafolesës, theksoi, po numri duhet të jetë dhe është tek sepse 5 anëtar/e janë nga komunitetet jo shumicë dhe 4 anëtar/e nga Kuvendi i Komunës, pra 9 janë krejt.

**znj.Qëndresë Hajrizi**, theksoi, ne Grupi i LVV-së i rekomandojmë Kuvendit propozim vendimin për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe emrat e anëtarëve të propozuar do t'i propozojmë nesër në seancën e Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, në rregull atëherë normale që emrat do të propozohen nesër në mbledhjen e Kuvendit por sot vetëm si numër dhe përbërje mund të flasim në menysë që ta kemi si orientim sa i përket ndarjes së vendeve nga radhët e Kuvendit që të mos ndodh të dalim me nga 2, 3 apo 4 propozime, por të kemi një unifikim sot nëse është e mundur.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, i nderuar Kryesues edhe për këtë temë mendoj se sot do të ishte mirë të kaloj vetëm si propozim nga KPF për seancën e kuvendit e cila është caktuar të mbahet nesër dhe ku do të merret vendimi final se qysh do të jetë përbërja dhe cilët do të jenë emrat. E them këtë se mund të jetë paksa e pakuptimtë që nëse ne sot nxjerrim një përbërje, kurse nesër në Kuvend mund të bie poshtë ajo përbërje, kështu që do të propozojmë që sot vetëm të kaloj si pikë e rendit të ditës për në Kuvend dhe nesër në mbledhjen e Kuvendit të vendoset se cila do të jetë formula dhe cilët do të jenë emrat e të propozuarve, pra kjo më duket që është më arsyeshme.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, jemi në dijeni se çdo kund dhe për çka do Kuvendi ka të drejtë të ndryshoj rekomandimet qoftë edhe si propozim që mund të japim ne sot në këtë Komitet, kështu që ne sot mund të mos japim emra apo formulë të përbërjes, mirëpo si formulë orientuese të jetë kjo që e diskutuam.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, ne sot po votojmë që kjo pikë e rendit të ditës të rekomandohet për seancën e Kuvendit. T'ju them të drejtën nuk është që nuk u pajtova kështu si komplet sepse e dim që partisë së parë i takon përqindja më shumë dhe nuk mund të them që neve të na ndahen 2 vende kurse këta (LVV) të marrin 1 sepse, as përgjysmë nuk mund ta ndajmë, kështu që unë pajtohem përafërsisht dhe nesër në Kuvend ne e japim propozim tonë dhe nuk e besoj që do të ketë ndonjë problem për këtë far pune.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, dhe që emrat e anëtarëve nga Kuvendi të propozohen nesër si dhe për propozimet e sjella nga komunitetet jo shumicë të votohet veç e veç.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, me theksim që emrat e anëtarëve të propozohen në mbledhjen e Kuvendit si dhe për propozimet e komuniteteve jo shumicë të votohet veç e veç, për secilin përfaqësues të propozuar.*

#### **4. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës**

**z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit**, theksoi, kemi edhe këtë pikë të rendit të ditës të, propozuar nga Drejtoria e Arsimit, që është propozim për ngritjen për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës. Propozim vendimi ju është përcjellë me kohë dhe keni mund të shikoni se janë dy propozime të emrave që janë Blerim Vllasa zyrtar i arsimit të mesëm dhe të lartë në Drejtorinë e Arsimit, si dhe Bahrie Talla drejtoresh e SHFMU “Hyzriu dhe Samiu” në fshatin Letanc. Unë i kam shikuar dispozitat ligjore dhe kam parë se është bazuar ashtu siç kërkohet në bazë të Rregullores përkatëse nr.19/2024, sa i përket propozimit të dy kandidatëve, andaj urdhëroni unë e hap debatin rreth kësaj pike, por paraprakisht ju informoj se drejtori i DKA-së z.Avni Fetahu është në udhëtim jashtë vendit dhe sot nuk ka mund të jetë prezent në mbledhje.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, zakonisht kur kanë ardhë këto propozime edhe në mbledhjet e kaluara, unë nuk është që pajtohem por megjithatë në këtë pikë nuk i ka fajet drejtori i DKA-së sepse për mua Udhëzimi Administrativ është shumë gabim ngase ne si anëtar të Kuvendit të ngarkohemi të votojmë një komision prej 2 anëtarëve kur ata neve nuk na japin llogari. Unë zakonisht kështu edhe parimisht nuk e votoj një njeri as në komision as askund nëse ai nuk jep llogari dhe përgjegjësi këtu, mirëpo e ka caktuar kështu qysh e ka caktuar.

Këtu mungon lista ashtu qysh ka ardhë zakonisht se në cilat shkolla do të zgjidhet zëvendësdrejtori, në cilat drejtori, kurse më parë është ardhë ajo listë, shembull ka qenë që në shkollën “Naim Frashëri” do të zgjidhet drejtori i shkollës, pastaj në NN shkollën do të zgjidhet zëvendësdrejtori, kurse tani nuk e ka sjellë atë listë të shkollave, nuk e di pse por në material mungon.

Në nenin që është thirr ky propozim vendim, neni 14 pika 8.1 thuhet që dy anëtar/e duhet të zgjidhen, këtu precizohet pak më mirë ku thuhet se DKA duhet t'i zgjedh dy anëtarë, kurse një anëtar Ministria e Arsimit, njëri duhet të jetë ekspert i pavarur dhe tjetri zyrtar i arsimit në Komunë, ndërsa nuk është propozuar eksperti i pavarur i arsimit por është zgjedh një drejtor shkollë, madje këtu në Udhëzim precizohet se duhet të jetë me performancë shumë të lartë kurse ne nuk e dim se a është sjellë ndonjë

raport se a është më e mira drejtoresh ajo që e ka propozuar drejtori i DKA-së sepse kërkohet të jetë shumë profesionale, nuk e di, por unë do të kërkoja prej drejtorit të DKA-së edhe pse nuk qenka prezent këtu, ta sjellë listën e shkollave se ku do të sjellën drejtorët dhe zëvendës drejtorët.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, mirë do të ishte që sot të jetë prezent drejtori i DKA-së dhe të jap sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme, mirëpo është në udhëtim zyrtar jashtë vendit siç ju njoftova pak më parë, por meqë nga kolegët po njoftohem se nesër do të jetë prezent në sallë besoj se do t'i jep të gjitha përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, andaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **5. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026**

**z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit**, theksoi, tani në rend të ditës kemi propozim vendimin për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026, dhe këtu prezentë është drejtoresha e Drejtorisë përkatëse, andaj i'a japim fjalën që ta paraqes këtë propozim vendim.

**znj.Saranda Stublla-Uka**, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, duke e paraqitur fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra si pikë e rendit të ditës kemi miratimin e Listës së veçantë të pronave të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, andaj kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni dhe t'ia rekomandoni Kuvendit për miratim.

**znj.Adelinë Stublla**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të Listës së veçantë të pronave të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2026.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës i nderuari Kryesues unë e kam një problem, në, fakt neve në muajin maj ose qershor të vitit të kaluar neve na është sjellë një propozim të cilin unë e kam kundërshtuar në atë kohë sepse ligji nuk e lejon që gjatë vitit të sjellët Listë e që në atë mbledhje ne Grupi i LDK-së e patëm lëshuar sallën për çka u patëm kritikuar, por pastaj Ministria e pati kthyer të paligjshme dhe vendimin që e ka kthyer të paligjshme e kam këtu, kurse tani prapë po vie mërzi që tani ne ta nisim në këtë mandat sepse këtë Ministria do ta kthej të paligjshëm sepse është i paligjshëm.

Nëse keni pak durim unë do ta lexoj arsyen përse Ministria e ka kthyer të paligjshme: arsyeja e anulimit të vendimit, Komuna duhet ta publikoj listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listën e veçantë të pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues deri më 31 dhjetor duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik lokal të Komunës.

Do të thotë këtu mungon Lista e përgjithshme dhe është vetëm një listë e veçantë e cila është shumë pak, si dhe data e fundit kur kjo listë është dashtë të miratohet ka qenë 31 dhjetori i vitit të kaluar, përndryshe ne tani mund ta votojmë këtë dhe ta dërgojmë në Ministri por në asnjë mënyrë nuk do të kaloj në Ministri dhe do të kthehet e paligjshme.

Komuna e Prishtinës e ka miratuar me kohë para 31 dhjetorit të vitit të kaluar dhe i'a ka anuluar Ministria veç pse nuk e ka qitë Listën e përgjithshme, kurse shembull në këtë që kemi para vetës i kan qitë shumë pak në listë, përndryshe ne mund ta votojmë por kjo nuk kalon dhe këtë e din drejtoresha e DPKGJ.

Çështja e dytë është se kur është sjellë kjo Listë është dashtë të sjellët edhe raporti e komplet pronave në mënyrë që ta dimë se çka ka përfituar Komuna prej atyre pronave, cilat janë në shfrytëzim, cilat janë me qira dhe të ketë një farë sqarimi.

Pastaj një listë tjetër që e pash mu duk goxha interesante ishte ajo e stadiumit të KF Llapit, këtu neve nuk na e kanë definuar ende, andaj mu duk paksa interesante sepse ajo pronë është pronë shoqërore KF Llapit-Podujevë, a ka mundësi ne ta dim dhe të shohim kontratën e asaj se për sa vite e ka, sa paguan, a është pronë e Komunës a është pronë shoqërore, të na shpjegohet pak edhe neve. Unë e di që njëherë kanë shkuar atje dhe i kanë vënë disa shirita dhe pastaj sërish i kanë heq, dhe prap nuk dihet a paguan ai apo jo, a kontratë apo deri kur e ka, ose mos i ka skaduar dhe nuk po e qesin, po e shantazhin ndokush atë, po na shantazhin ai neve a, çështje këto që unë ende nuk i kam të karta me ditë sakt kush paguan për ato lokale që janë aty ose saktësisht për pronën kush paguan tatim a deri kur e ka kontratën, të shpjegohet kjo pak sepse e meritojmë sepse edhe neve na bëhen disa pyetje prej qytetarëve siç është ky shembull se e kujt është ajo pronë, kurse ai personi e thotë se kjo pronë është e imja, ne themi është e jona, andaj meqë është kjo gjendje a ka mundësi ta shohim ne kush dhe sa paguan, e meritojmë të na tregohet kjo pjesë.

Kështu që unë ë këtë pikë të rendit të ditës unë do të thoja ta heqim nga rendi i ditës, nuk e di përse t'ia nisim vitit ne kur e dim sakt që Ministria e kthen ose dikush dikujt i ka borxh dhe i thotë që hajt se qes e opozita e kundërshton dhe këta e kanë fajin sepse edhe kështu ka ndodh në të kaluarën, prandaj unë nuk e votoj këtë sepse kur e di që një sen e kthen Ministria, si e bëmë si nuk e bëmë këtë Ministria e kthen dhe s'ka shanse në asnjë mënyrë ta kaloj, përndryshe këtu është edhe Zyra ligjore dhe nuk e di a kanë dhënë leje me sjellë këtë këtu apo nuk i ka pyet askush, nuk e di këtë, kështu që unë mendoj kështu.

**znj.Saranda Stublla-Uka**, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, në muaj maj 2025 nuk ka qenë Lista e veçantë e pronave, por ka qenë ndryshimi i të dhënave të një parcele e cila ka qenë afati për ta dhënë në shfrytëzim, pra kjo ka qenë ndryshimi dhe nuk e pati aprovuar Ministria, do të thotë ka potencuar se është në kundërshtim me ligjin, ndërsa këtu kemi të bëjmë me Listën e veçantë të pronave që ashtu siç e potencoi parafolësi duhet të miratohet deri në fund të dhjetorit të vitit paraprak, mirëpo për shkak të konstituimit të Kuvendit ka ardh tani, ne në fakt kemi pas edhe kontakte me ministrinë përkatëse dhe na është thënë që ta sjellim në këtë seancë të muajit janar 2026 dhe ne e kemi bërë përgatitjen e materialit dhe e kemi sjellë në këtë seancë.

Sa i përket stadiumit të qytetit, unë e ka shpjeguar edhe herëve të kaluara, nuk e di sa keni qenë prezent këtu, por ne kemi hulumtuar edhe vendimet e mëhershme të Kuvendit dhe nuk kemi gjete asnjë vendim që Kuvendi i Komunës e ka dhënë në shfrytëzim atë pronë, ai thirret që është pronë e tij, ne e kemi gjete edhe historiatin e asaj prone dhe kurdo mund të vini dhe ta merrni në arkivat e kadastrit e që në fletën poseduese të vitit 1960 dhe gjithëherë figuron si pronë shoqërore KF Llapit, kurse se qysh në vitin 2017 është vendos në fletën poseduese vërejtja se i jepet në shfrytëzim, unë nuk e di, vendim nuk ka, jemi konsultuar edhe me Zyrën ligjore, kemi kërkuar vendime por nuk kemi gjetur, kjo është çka mund të jap sqarime rreth kësaj çështje.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, e nderuar drejtoresh, unë nuk e di pse ne duhet të vijmë atje në zyrë, këtu duhet të na i sillni dokumentet. Unë shembull e di që në Statusin e tij shkruan që Klubi është privat, është Sh.P.K KF Llapit 1932, kurse këtu pash se shkruan pronë shoqërore e KF Llapit, do të thotë ashtu qysh e ka pas emrin më parë. Unë pak a shumë e kuptoj dhe kjo që u tha nuk është arsyetim që u tha se nuk kemi gjete sepse diku duhet të jenë ato letra sepse nëse dikush i ka thënë atij personi vetëm shko hy aty, le të shkoj në përgjegjësi ai që i'a ka dhënë. Pra unë mendoj që ne si qytetarë të Podujevës e meritojmë të dim sakt qysh është ajo pronë aty, se për që sillet ai sikur ta ketë të privatizuar komplet e dim, mirëpo ai le që këtu në qytet por as në fshatin Dumosh këto ekipet tjera ose shkollat e futbollit i'u thotë që nëse doni të shkoni e të luani jua merr 70€, andaj duhet të sqarohet kjo punë mirë dhe t'i tregohet atij që kjo pronë është pronë e Komunës, këto lokale duhet ti qesim kështu e ashtu t'i merr kush t'i merr dhe kush i

shfrytëzon e paguan edhe qiranë se jo kështu të jetë siç është por duhet të zgjidhet kjo ose duhet të tregohet sakt ose të thuhet se nuk po e gjejmë, ne duhet ta votojmë për ta qitë e pastaj të konkurron kushdo dhe ta merre atë pjese, nuk po them t'i merret fusha, por bile lokalet bile dhe të shfrytëzohen, e jo ai ato i shfrytëzon, andej shkollave të futbollit i'u merr para, mandej po të shkojmë në stadium na i merr paratë e hyrjes, nuk po e di, është paksa e komplikuar.

Sa i përket pjesës që drejtoresha parafolëse e tha se janë konsultuar me Ministrinë, nëse jeni konsultuar është dashtë të na e sjellni një letër dhe të na thoni se Ministria ka thënë kështu, por unë nuk është që i besoj kësaj pune. Nëse Ministria e kalon këtë unë do ta marrë vendimin e Komunës së Prishtinës pse asaj i'a ka kthyer dhe përse neve nuk na e kthen, pra nëse për Komunën e Prishtinës MAPL vendos veç pse nuk im ka qitë pronat e përgjithshme dhe ta anuloj, kurse këtu nuk janë as pronat e përgjithshme dhe është jashtë afatit e neve na e kalon, do të thotë shqyrr që qenkemi ne aq të mirë dhe kaq të fortë dhe mund ta kalojmë, a kjo të kaloj kurrë hiq dhe unë tani ju tregoj se shanse nuk ka, si dhe besoj që edhe ju e dini që nuk kalon, por dikush dikujt po i thotë që këna me i qitë e pastaj i thoni jo këta s'po lën jo ata s'po lën, përndryshe unë e kam obligim që edhe nesër në seancën e Kuvendit të dal dhe ta shpjegoj këtë, besoj që kjo nuk e ligjshme dhe s'ka shanse të kaloj hiq, nëse kthehet e ligjshme ka me u mbajtë mbledhje dhe do t'i kthehet edhe Komunës së Prishtinës e ligjshme, sepse "për dikë nënë e për dikë njerë nuk ka".

**znj.Saranda Stublla-Uka**, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i përket stadiumit, i nderuar asamblistë, unë nesër do ta sjellë historiatin e asaj parcele me fletë poseduese me të gjitha tjerat, vendime të Kuvendit në arkivën e kadastrit nuk ka, e potencova edhe njëherë më parë, po ashtu edhe me Zyrën ligjore kemi diskutuar dhe na është thënë se nuk ka vendim.

Sa i përket Listës së veçantë të pronave besoj që është mirë të shikohet pak më mirë pse i është kthyer e paligjshme Komunës së Prishtinës.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, arsyetimi ka qenë që nuk është Lista e përgjithshme, e që nuk e ke as ti tani. Pastaj shembull, unë një pronë në fshatin Siboc nuk e pash që është në këtë Listë hiq, në vitin 2024 në muajin dhjetor diku me datën 29 nëse nuk gaboj e kemi mbajtur seancën dhe e kemi votuar Listën për me dal dhe ka dal ajo parcelë, mandej unë jam votuar si anëtar i komisionit edhe kurrë askush nuk më ka thirr në komision, kurse aty tani ka ardh një perona dhe po e punon atë tokë, andaj nëse ju ja keni dhënë, kurse ne jemi zgjedh anëtar të komisionit dhe ju ja keni dhënë ati personi atë pronë në shfrytëzim, kurse mua si anëtar të komisionit nuk më keni thirr hiq, por keni vendos ju vet me ja dhënë, atëherë cila është arsyeja të na zgjidhni anëtar të komisionit, mirëpo nëse ju hiq nuk e keni qitë por vetëm ka ardh dikush dhe e punon atë pronë atëherë këtu duhet ta kemi raportin që ta dim ne dhe e meritojmë ta dim se cilat janë prona të Komunës, kush i shfrytëzon, kush i ka uzurpuar, sa paguajnë, sa kanë kontrata, pra ti dim paksa format e tilla, madje edhe duhet të publikohen në faqe të Komunës që të dihen se cilat janë, ku i kemi pronat, kush i shfrytëzon, a i kanë marrë veç që janë të fortë a.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, ne e kemi parë që propozimi ka ardh nga Drejtoria përkatëse, t'ju them të drejtën edhe unë jam interesuar për ato çështje që u cekën mirëpo kamë parë edhe arsye tjera që kanë qenë për Komunën e Prishtinës, por si do ku do Ministria është organ më i lartë se ne dhe ajo na tregon a është i ligjshëm apo jo, andaj urdhëroni nëse edhe ndokush dëshiron fjalën.

**z.Ekrem Rrahmani**, sërish debatoi me U.D. drejtoreshën parafolëse sa i përket këtij propozim vendimi duke theksuar se po çuditëm qysh e dini që është i paligjshëm ky vendim dhe këtë do t'jua kthej Ministria dhe sërish dëshironi ta miratoni, jeni thirrë në nenin përkatës i cili bash e precizon që kjo Listë duhet të miratohet më së largu deri më 31 dhjetor të vitit paraprak. Përndryshe siç thekson ai, unë do ta përcjellë këtë çështje në Ministri dhe nëse është nevoja edhe me e-maile të përditshme do t'iu drejtohem sepse është vendim i paligjshëm, nuk do ta lëshoj këtë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, meqë nuk po vërejë që ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim në seancën e nesërme.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri, me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

*Duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë rreth kësaj mbledhje, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:05**

**Procesverbalin e mbajti;  
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0006008/26  
Podujevë,  
28 janar 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit  
Isak Shabani**